

POETIC MONOLOGUE LULLABIES, SPIRITUAL RENEWABLE HERITAGE IN DIFFERENT SOCIO-ECONOMIC CIRCUMSTANCES NINULLAT MONOLOG POETIK, TRASHËGIMI SHPIRTËRORE E RIPËRTËRISHME NË RRETHANA TË NDRYSHME SOCIO-EKONOMIKE

JEHONA HAJRULLAHU
PRISHTINË, KOSOVË
E-MAIL: H_JEHONA@HOTMAIL.COM

AKTET VI, 5: 517 - 520, 2013

PËRMBLEDHJE

Qëllimi i këtij punimi është trajtimi i fushës së letërsisë gojore, përkatësisht ninullave, të cilat janë krijuar në periudha të ndryshme të zhvillimit socio-ekonomik të shoqërisë shqiptare me fokus në Kosovë. Ninullat vlerësohen si pjesë e rëndësishme e krijimtarisë letrare popullore e që në fakt shprehin traditën e fushës së kulturës shpirtërore të trashëguar, por edhe krijimet e reja me qasjen aktuale të avancuar, duke ju përshtatur rrethanave të reja. Ninullat janë përqendruar te figurat historike, legjendare, sikur edhe te figurat që shprehin urti dhe mençuri deri në ditët e sotme. Studimi i krijimit të ninullave ka një qasje ndryshe në rastet kur personifikohen figura legjendare, figura trimërie, diturie e urtësie. Ky punim kryesisht është i bazuar në materiale, botime të ndryshme të kësaj fushe, të regjistruar në terren në disa pjesë të Kosovës, të cilat shpërfaqin një begati kulturore e shpirtërore të popullit shqiptar të Kosovës dhe na përkujtojnë figurat kontribuese në këtë lloj të lirikës familjare.

Fjalët çelës: Kulturë shpirtërore, krijime letrare popullore

SUMMARY

The purpose of this paper is a treatment of the folk literature field respectively lullabies which are created in different periods of socio - economic development with a focus on Kosovo to Albanian society. Lullabies evaluated as an important part of folk literary creativity which in fact express the spiritual tradition field of inherited culture, but also new creations with current approach to advanced. Lullabies are focused on historical figures, legendary, as well as figures that express the wisdom until today that creation of lullabies has a different approach in cases when personified legendary figures, courage figures, knowledge and wisdom figures. Created lullabies in certain periods express socio - economic and intellectual advancement of the Albanians in Kosovo. This paper is mainly based on the material, various publications in this field as well as research methods on the ground in some parts of Kosovo, which exhibit a cultural and spiritual wealth of Albanian people of Kosovo, for while these lullaby remind us contributing figures for different periods of Albanians are expressed figures who have acted with dignity for national issue.

Key words: Intangible culture, folk literary creations.

Hyrje

Letërsia gojore shqiptare në përgjithësi është e pasur me motive të shumta, që karakterizohen me një begati të ndjenjave që përshkruajnë jetën shpirtërore, morale e historike të popullit tonë në të gjitha aspektet e zhvillimit të tij. Lloji i lirikës ka një histori të lashtë. Ajo ndër shekuj është

zhvilluar si refleksion i vitalitetit të popullit tonë, edhe përkundër vuajtjeve dhe sakrificave të përcjella në kushte të caktuara historiko-shoqërore, duke mos i përjashtuar rrjedhat e përgjithshme dhe ndryshimet që i kanë përcjellë deri në ditët e sotme. Një rëndësi të veçantë dhe një pasuri të lirikës gojore paraqesin ninullat. Pra,

ninullat si krijime individuale me elemente improvizuese e figuracione të veçanta, të zgjedhura me një shije të hollë poetike, pa dyshim, se janë një nga llojet e krijimtarisë gojore të pasura letrare, të cilat akoma e ruajnë freskinë e tyre krijuese.

Ninullat (nina-nanat) si krijime individuale kanë shprehur imagjinatën, ëndrrën dhe dëshirën e nënave që fëmijët e tyre të kenë tipare të një njeriu apo personaliteti të suksesshëm, dikur si bari, pleqnarë, trim. Derisa, figurat në ninulla, kanë qenë të ndryshme varësisht nga evoluimet në shoqëri, në asnjë moment nuk janë përjashtuar nga repertori i ninullave edhe figurat më të hershme, por edhe ato të periudhave historike të shqiptarëve që kryesisht kanë qenë figura kombëtare. Kështu flasim për një trashëgimi shpirtërore të bartur brez pas brezi. Megjithatë, me kohë nuk janë lënë anash edhe krijimet e reja që përbëjnë një tërësi dhe ripërtëritje të kësaj fushe të krijimtarisë popullore në fushën e zëvendësimit të figurave të vjetra me figura të reja.

Ninullat janë përqendruar te figurat historike, legjendare dikur, sikur që edhe në ditët e sotme nuk janë lënë anash aspak figurat legjendare, kreshnike ato të urtësisë dhe mençurisë. Meqë populli shqiptar ka një letërsi të pasur që daton në kohëra të lashta. Ajo ka qenë me interes për studime të shumta nga studiues dhe autorë të njohur vendas dhe të huaj.

Ninullat shqipe pasqyrojnë virtytet më të çmuara të popullit e ruhen edhe sot

Në ninullat shqiptare në përgjithësi, sikur edhe ninullat e Kosovës, nëna përmes vargjeve të shprehura të lidhura me figura të ndritshme kombëtare të popullit shqiptar, tregon fuqishëm lidhjet e saj me dëshirën që fëmija i saj të bëhet i mençur, i urtë, trim, luftëtar i mirë, virtyte këto, që shprehin një gjendje të plotësuar të një personaliteti. Sipas studiuesit Sadri Fetiu: “Këto krijime poetike, sado që mbështeten mbi bazën e improvizimit të drejtëpërdrejtë, sado që në esencë e kanë funksionin utilitar të përcaktuar drejtpërdrejt nga qëllimi që foshnja të vihet në gjumë, në shumicën e rasteve janë shfrime lirike që në bazë të fantazisë për të ardhmen e foshnjës

paraqesin vizione të gjëra jetësore brenda raporteve të caktuara shoqërore, historike dhe etnopsikologjike të popullit tonë”.

Duke dashur që fëmijët e tyre të arrijnë të bëhen një personalitet i plotë, nënat shqiptare atyre përherë u kanë kënduar e u këndojnë këngë që frymojnë sipas tipareve të legjendarit, trimit, të urtit e natarit. Por si edhe në ninullat e kohëve më të vjetra edhe në ditët e sotme, figura qendrore është figura e trimit, kreshnikut e luftëtarit. Këto figura ku vie në shprehje burëria, trimëria dhe figura e një luftëtari të paepur, mbase kanë qenë të imponuara si elemente të ninullave, meqë shqiptarët ndër epoka kanë qenë të sfiduar me asimilimin si komb, por edhe si tërësi territoriale. Duke qenë të vetëdijshëm se kemi një krijimtari të vlefshme dhe, në këtë rast është me interes të pasqyrojmë krijimtarinë muzikore-letrare të ninullave.

Janë ninullat shqipe ato të cilat pasqyrojnë dhe shprehin virtytet më të çmuara të popullit shqiptar sikur që janë urtësia, trimëria e shpesh herë edhe ninullat me karakter epiko-heroik, në të cilat nëna shqiptare ka shprehur ndjenjat e saj për perspektivën e fëmijës së saj përmes figurave historike kombëtare sikurse që janë këto më poshtë:

NINA -NANA N'DJEP ME KLEKA

Nina-nana, n'djep me kleka²
m'u bafsh trim si Haxhi Zeka!
Nina-nana, po t'përkuni,
u bafsh trim si Bajram Curri!
Bajram Curri n'Dragobi
ka luftue me ni ordi.
Djali jem lula e blinit,
t'l m'l gafsh Is Boletinit,
m'l gafsh Mujës dhe Halilit!

Tomoc-Istog, 1974

Në këto vargje në radhë të parë shohim se është ruajtur struktura e vargjeve të ninullës, vargu i parë dhe i tretë janë vargje të njohura për ninullat në tërësi, ndërsa në vargjet në vazhdim paraqiten mesazhet e përcjella nga nëna për të ardhmen e lumtur të fëmijës si një figurë morale me virtyte të tjera si për urtësinë, trimërinë,

dëshirën dhe idealin e saj të spikatur prej heroizmi dhe trimërie, që biri i saj t'i bëhet i mençur, trim.

Gjerësia krijuese e ninullave shqiptare përveç funksionit të tyre themelor me gjithë prirjet artistike, të paraqitura figurshëm përmes krahasimit, metaforës, epitetit, e figurave të tjera janë një dëshmi e synimeve të nënës për përngjasimin e fëmijës së saj me ato figura që edhe janë paraqitur në ninullat dikur, por edhe në ditët e sotme. Ngjarjet e kohës, duke ju përshtatur rrethanave të reja edhe krijimet e reja me qasjen aktuale të avancuar, ku figurat legjendare janë marrë nga koha e sotme, duke përfshirë në ninulla, kështu figurat e shquara të periudhës së tranzicionit, që shprehin mençuri, urtësi e tolerancë e paqe. Përveç trajtimit të përmbajtjes së ninullave të marra një strukturë e njëjtë e ninullave me elemente dhe me figurat kryesore të lartpërmendura i kemi hasur edhe në terren ku kemi zhvilluar një studim sikur që shpreh ninulla në vijim. Nuk ndryshon struktura apo përmbajtja e ninullave as në ditët e sotme, përveç se figurat qendrore në ninulla tani janë të kohërave të sotme, por pa përjashtuar prap trimërinë, figurën e luftëtarit e atij të urtit e të mençurit.

NINA - NANA N'DJEP TË SHINIT

Nina-nana, n'djep të shinit,
ti mu bofsh sikur Naimi!
Nina-nana n'djep të votres
Ti je djali i bardhokës
Nina-nana, n'djep me shina,
ti m'u bofsh trim si Hasan Prishtina!
Nina-nana, n'djep me fleta,
ti mu bofsh trim si Azem Bejta!
Nina-nana more djalë
Ti m'u rritsh me faqe t'bardhë.

NINA-NANA MA BARDH SE BORA

Nina-nana ma bardh se bora
ti m'u bofsh si Ibrahim Rugova!
Nina-nana xhamper me grisha
ti m'u bofsh si Sali Berisha
t'japim ujë pej ujit t'bunarit
ti mu bofsh si Azem Hajdari!

Nina-nana djalit tem
si Azem Hajdari mu bofsh n'ketë ven
ty te krytë ta rrehi defin
e mu bofsh kryetar shteti!

Ishin këto ninulla, me figura e personalitete të periudhave kohore të ndryshme, të largëta ose të afërta historike, sikurse ato të viteve të 90-ta, që këndohen edhe sot në Kosovë e që na përkujtojnë figurat kontribuese për periudha të ndryshme që të shqiptarët janë të dëshmuara me veprimtarinë e tyre dinjitoze për çështjen kombëtare.

Përfundim

Mund të themi se krahas transformimeve të shumta në jetën shoqërore socio-ekonomike, populli shqiptar ruan me xhelozri krijimtarinë letrare edhe në ditët e sotme. Me theks të veçantë e me një përkushtim të madh vërehet edhe te lirika gojore. Ninullat duke u bartur brez pas brezi kanë përcjellë traditën gojore lirike, me të cilën populli shqiptar radhitet krahas popujve të tjerë. E rëndësishme është që pavarësisht ecjes përpara drejt një kohe të moderuar, ninullat vijojnë të këndohen ndër shqiptarët në çdo cep të botës ku jetojnë e veprojnë ata. Jo rrallë, mbase kam qenë edhe vetë dëshmitare kur nëna duke vënë në gjumë fëmijën përmes ninullave i sjell në kujtesë figurat e dikurshme e të ndritshme të kombit. Krahas figurave të lashtësisë me një zë po aq të ëmbël këndon ninulla edhe për figura e personalitete të ndritura të kohës së re. Pra duke parë se kemi te bëjmë me një fushë krijimtarie në mënyrë të vazhdueshme siç është rasti i ninullave me pak transformime varësisht nga periudhat e zhvillimit historik, mendojmë se studiuesit e lirikës gjegjësisht ninullave nuk kanë pse të ndalen, por mund të vazhdojnë gjithëherë me hulumtime dhe studime në krijimtarinë popullore siç janë ninullat. Deri në këtë periudhë mbase mbetemi të kënaqur me trajtimin e kësaj fushe, gjithashtu shpresoj që kjo krijimtari popullore që shpreh trashëgiminë shpirtërore të popullit shqiptar të mos mbetet në këtë stad, por të avancohet sikur edhe të trajtohet nga studiues të kësaj fushe si

pjesë e rëndësishme e letërsisë së përgjithshme shqiptare.

Bibliografia

DANÇETIVIÇ, S. Vojisllav – ÇETTA, Anton (1953), *Kangë Popullore Shqiptare të Kosovë-Metohis*, Sh. B. Mustafa Bakija, Prishtinë, Bleni III.

FETIU, Sadri (1982), *Ninulla*, vëllimi VIII, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë.

PLLANA, Shefqet (1970), *Këngët e lindjes dhe ninullat shqiptare të Kosovës: Glasnik Muzeja Kosova – Buletini i Muzeut të Kosovës, X*, 1965-1970, Prishtinë.

PLLANA, Shefqet (2004), *Studime në fushën e Folklorit*, Fakulteti i Filologjisë, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë.

SHALA, Demush (1972), *Këngë popullore lirike*, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë.

SULEJMANI, Fadil (1988), *Lindja, martesë dhe mortja në Malësinë e Tetovës*, Rilindja, Prishtinë.

VASILI, Kozma-DOJA Albert (1990), *Këngë të lindjes dhe ninulla, Lirika Popullore*, Vëllimi IV, Instituti i Kulturës Popullore, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë.

Shënim: Materialet e mbledhura në terren janë brenda periudhës kohore (2011 – 2012)..
